

VENDIM
Nr. 453, datë 26.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHËNEPREMTE”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shënepremte”, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 300 m², me vlerë të përgjithshme 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Divjakë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Divjakë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Divjakë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Divjakë dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTT
 “ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHËNËPREMTE”, NJËSIA ADMINISTRATIVE
 TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja tokë arë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Faslli Kasmi	473/1	3341	300	109,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				109 200	